



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet për profesionet e lira
- * Trajnimi i Trajnuesve

Shkurt 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Programi praktik për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës në institucionet gjyqësore në Kosovë

Më 07-25 shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë në vazhden e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës përmes Ambasadës Franceze në Kosovë, ka organizuar programin praktik në institucionet gjyqësore në Kosovë, për dy kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës (ENM), znj. Agnès Legagne dhe znj. Julia Depetris.

Fillimisht, kandidatet janë mirëpritur në takim nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu dhe znj. Valmira Pefqeli, Udhëheqëse e PTF-së, ku kandidatet nga Shkolla e Magjistraturës së Francës u njoftuan me organizimin dhe sistemin e programeve të Akademisë së Drejtësisë, sistemin gjyqësor në përgjithësi në Kosovë, si dhe u udhëzuan për vazhdimin e qëndrimit të tyre në institucionet përkatëse.

Më pas, kandidatet e ENM-së kanë vazhduar takimin me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, z. Kujtim Munishi, ku janë njoftuar për së afërmi me punën në prokurori si dhe rastet që i pranon kjo prokurori. Nga kryeprokurori Munishi është konfirmuar që do të jetë institucion i pritës gjatë praktikës së tyre në zyrat e Prokurorisë Themelore të Prishtinës.

Ky program praktik ka zgjatë tri javë, ku kandidatet nga ENM kanë pasur mundësinë që të vizitojnë dhe të shohin punën praktike të prokurorive dhe gjykatave nga të gjitha nivelet në Kosovë, si dhe kanë zhvilluar takime informuese edhe me bashkëpunëtorë vendorë dhe ndërkombëtarë të AD-së, varësisht prej temave të interesit të tyre.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Më 28 shkurt 2022, në Akademinë e Drejtësisë, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Vatton Durguti, Udhëheqës i Departamentit Special në Gjykatën e Apelit.

Në këtë takim anëtarët e Këshillit Drejtues sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, fillimisht shqyrtuan planin e veprimit 2021-2022 për zbatimin e Strategjisë së Sundimit të Ligjit 2021-2026, me këtë rast autorizuan Akademinë e Drejtësisë për zbatimin e aktiviteteve të parapara, njëkohësisht duke miratuar edhe propozimin

për amendamentimin e planit të punës së AD-së, për të përfshirë aktivitetet e dala nga ky plan i veprimit.

Gjithashtu, gjatë këtij takimi Këshilli Drejtues ka shqyrtuar disa vendime të KPK-së për trajnimet e detyrueshme të prokurorëve si dhe u informuan nga Drejtori Ekzekutiv në lidhje me ecurinë e punës së ndërtimit të objektit të ri të AD-së.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata (VIII) gjatë muajit shkurt

Gjatë muajit shkurt, gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata VIII kanë vazhduar sipas programit trajnues të përcaktuar për këtë gjeneratë trajnimit praktik në gjykatat përkatëse. Aspekti praktik i trajnimit është monitoruar nga gjyqtarët mentorë të cilët në baza të rregullta kanë njoftuar Akademinë e Drejtësisë për ecurinë dhe mbarëvajtjen e këtij trajnimi.

Krahas trajnimit dhe mbarëvajtjes së trajnimit praktik, bazuar në Rregulloren e PTF-së gjyqtarët e sapo emëruar kanë qenë të obliguar që të hartojnë punime hulumtuese të cilat sipas vendimit të Këshillit Drejtues do të vlerësohen nga trajnuesit e PTF-së dhe të njëjtat bashkë

me testin përfundimtar do të bashkëngjiten dosjes për përfundimin e trajnimit fillestar.

Gjithashtu Akademia e Drejtësisë gjatë muajit shkurt ka hartuar testin përfundimtarë në fushën penale për këtë gjeneratë. Testi është hartuar nga grupi punues i përbërë nga trajnuesit e PTF-së të fushës penale me të cilin përmyllet testi përfundimtarë për 24 gjyqtarët e kësaj gjenerate.

Në vazhdim nga stafi përgjegjës i këtij programi janë bërë përgatitjet tjera të cilat i kontribuojnë realizimit të testit përfundimtar i cili pritet të jetë me 9 dhe 10 mars 2022.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Veprat Penale kundër narkotikëve me theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar

Më 01 Shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë “Veprat Penale kundër narkotikëve me theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me specifikat e veprave penale me narkotikë dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në praktikën gjyqësore.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të veprave penale kundër narkotikëve, duke i kushtuar kujdesë kuptimit të narkotikeve, llojit dhe ndarjes së tyre, si dhe pasojave që sjell përdorimi i tyre për shëndetin e njeriut. Më pas janë diskutuar veq e veq elementet e veprave penale kundër narkotikëve, duke paraqitur edhe raste praktike për mënyrën e identifikimit të këtyre elementeve në praktikë, pastaj mënyrën e sigurimit të provave dhe mënyrën e hetimeve

financiare lidhur më këto vepra. Një diskutim i rëndësishëm është zhvilluar edhe lidhur më format e organizuara të kryerjes së këtyre veprave penale dhe mënyrës së caktimit të sanksioneve penale lidhur më veprat penale të këtij kapitulli.

Gjithashtu në këtë trajnim janë diskutuar edhe rastet praktike lidhur me hetimet financiare, masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues, si mekanizma për luftimin e suksesshëm të veprave penale kundër narkotikëve.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve. Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë dhe Prokurorët nga niveli Themelor dhe gjyqtarë nga Apeli.



Trajnim: Shqyrtimi paraprak i padisë

Më 02 Shkurt 2022, është realizuar trajnimi online përmes platformës zoom me temë “Shqyrtimi paraprak i padisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë për zbatimin në mënyrë korrekte të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore sa i përket verifikimit të plotësimit të prezumimeve procedurale.

Trajnimi u fokusua në trajtimin teorik dhe praktik duke i kushtuar kujdes kuptimit të prezumimëve procedurale.


Më tutje është diskutuar për prezumimet procedurale lidhur me gjykatën, prezumimet procedurale lidhur me palët, lidhur me objektin e kontestit dhe prezumimet procedurale lidhur me padinë.

Diskutimi i rëndësishëm është zhvilluar edhe rreth hedhjes së padisë si të pa lejueshme gjatë

shqyrtimit paraprak të padisë, e po ashtu edhe për pasojat për zhvillimin dhe epilogun e tërë gjykimit që sjell mos kuptimi dhe shqyrtimi i këtyre prezumimeve procedurale që në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë. Po ashtu vëmendje të veçantë kishte edhe rreth hedhjes së palejuar të padisë në rastet kur mungojnë ndonjëri nga prezumimet procedurale të përkrahura më lartë, që në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, gjyqtarë dhe prokuror nga niveli Themelor.



Trajnim: Marrja e deklaratës së fëmijëve- viktimë nga eksperti - Sesion I

Më 02-03 shkurt 2022, është realizuar trajnimi me temë “Marrja e deklaratës së fëmijëve-viktimë nga eksperti - Sesion I”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me marrjen e deklaratës së fëmijëve viktimë dhe krijimin e praktikave më të mira të cilat kontribuojnë në mirëqenien e fëmijëve.

Trajnimi u fokusua në intervistimin forenzik të fëmijëve, metodat dhe teknikat e bisedës me fëmijën viktimë si dhe praktikat në lidhje me intervistimin forenzik të fëmijëve. Të gjitha këto u shoqëruan me raste praktike dhe në kontekst të Konventës për mbrojtjen e të

drejtave të fëmijëve janë vënë në pah çështjet që duhet pasur në konsideratë që fëmija të mos ri viktimizohet dhe të avancohet në mirëqenien e fëmijëve.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor nga Departamenti për të mitur, Departamenti i përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të rënda.



Trajnim: Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i provave

Më 08 Shkurt 2022, është realizuar trajnimi me temë “Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i provave”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për veprat penale kundër pasurisë me theks të veçantë në rastet e uzurpimit të paligjshëm të pronës për trajtimin e drejtë të rasteve nga subjektet përkatëse dhe zgjidhjen meritorë të këtyre veprave.


Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të Uzurpimit të paligjshëm dhe rikthimit të pronave, duke i kushtuar kujdes Infrastrukturës ligjore lidhur me Uzurpimin e pa ligjshëm, elementeve të veprës penale, sanksioneve penale, rasteve praktike, ngjashmërive dhe dallimeve në mes të kësaj vepre penale dhe pengimit të posedimit apo shkatërrimit të strukturave të paligjshme të ndërtuara në pronën e huaj, raporteve të Avokatit të Popullit, OSBE-së, si dhe Vendimeve të gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Gjatë trajnimit në veçanti janë diskutuar elementet e veprës penale të Uzurpimit të paligjshëm dhe rikthimit të pronave, duke paraqitur edhe raste praktike për mënyrën e identifikimit të këtyre elementeve në praktikë, pastaj mënyrën e sigurimit të provave dhe mënyrën e hetimeve lidhur me Uzurpimin e paligjshëm dhe rikthimit të pronave.

Një diskutim i rëndësishëm është zhvilluar edhe lidhur me ngjashmëritë dhe dallimet në mes të kësaj vepre penale dhe procedurave tjera – civile dhe administrative duke trajtuar edhe legjislacionin e këtyre fushave.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga gjykata Supreme, Apeli, gjyqtarë dhe Prokurorët nga niveli Themelore dhe staf administrativ nga gjyqësori.



Trajnim: Kontrolli gjyqësor ndaj vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit

Më 09 shkurt 2022 është realizuar trajnimi përmes platformës online me temën përkatëse. Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në procedurën e privatizimit dhe likuidimit.


Trajnimi u fokusua në autorizimet e Agjencisë në procesin e privatizimit, likuidimin si proces administrativ, trajtimin e kërkesave kreditore pranë autoritetit të likuidimit të NSH-ve si dhe në aprovimin dhe refuzimin e kërkesave pranë AKP-së. Pra, në trajtimin teorik dhe praktik të mjeteve juridike në dispozicion, të palëve me interes ligjor ndaj vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit”.

Më pas janë diskutuar veq e veq elementet e vendimet e AKP-se, duke paraqitur edhe raste

praktike për mënyrën e zgjidhjes së tyre, transformimi, shitja, pezullimi, udhezimi si dhe vendimet e tjera të AKP-së.

Gjithashtu në këtë trajnim janë dhenë edhe konkluzionet e përgjithshme sipas të cilave, Mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara arrijnë qëllimin e tyre. Përveç vendimeve gjykata jep edhe Udhëzime për AKP-në gjatë produres së likuidimit. Palët i kanë të gjitha mundësit që me iniciativën e vetë të sfidojnë çdo vendim të AKP-së në Gjykatë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët nga Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme si dhe gjyqtarë nga divizioni civil nga gjitha regjionet e Kosovës.



Dispozitat ligjore në lidhje me pasurinë e përbashkët dhe mbajtjen financiare

Më 09-10 Shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Iniciativën për Drejtësi dhe Barazi-INJECT, kanë realizuar trajnimin me temë “Dispozitat ligjore në lidhje me pasurinë e përbashkët dhe mbajtjen financiare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve për përmirësimin e efikasitetit në gjykimin dhe menaxhimin e lëndëve që kanë të bëjnë me pasurinë e përbashkët eliminimin e të gjitha paqartësive si dhe të zgjidhjes brenda afatit më të shkurtë të mundshëm të lëndëve të pazgjidhura.

Gjatë takimit u diskutuan dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi duke e krahasuar me dispozitat para ndryshimit, si dhe të legjislacionit që pritet të ndryshoj dhe plotësoj dispozitat për pasurinë e përbashkët me draftin e ri të Kodit Civil, me qëllimin më të mirë që në bazë të praktikës të evitohen pengesat eventuale në dispozitat përkatëse të propozuara

për plotësim ndryshim e që ndërlidhjen me pasurinë e përbashkët, pasurinë e veçantë, alimentacionin dhe ushqimin.

Gjatë kësaj punëtorie u trajtuan temat: Mbajtja Financiare dhe Alimentacioni – Legjislacioni, Diskutim i rasteve praktike, Ushqimi – Legjislacioni, Pasuria e përbashkët” – Legjislacioni, Diskutim i rasteve praktike.

Gjatë trajnimit u parashtruan pyetje dhe njëkohësisht përgjigje nga pjesëmarrësit me rastin e diskutimit të rasteve praktike, zbatimit të legjislacionit lidhur me temat e trajtuara dhe u këmbyen praktikatat më të mira në zgjidhjen e rasteve konkrete. Po ashtu secili prej pjesëmarrësve në trajnim ishte aktiv dhe ndanë përvojat dhe zgjidhjet e ofruara për rastet dhe situatat e caktuara.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin: Gjyqtarët nga gjykata e Apelit dhe gjyqtarë nga Gjykata Themelore.



Procedura kundërvajtësve sipas kërkesës se inspektoreve

Më 10 Shkurt 2022, është realizuar trajnimi online përmes platformës ZOOM me temë “Procedura kundërvajtësve sipas kërkesës se inspektoreve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve rreth zbatimit të ligjit të procedurës kundërvajtëse.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik të Ligjit për Kundërvajtje si dhe shumë ligje për Inspektoriatet në Republikën e Kosovës.


Gjatë trajnimit është trajtuar fillimi i procedurës apo inicimi i procedurës së kundërvajtjes nga ana e inspektorëve, procedura e kundërvajtjes para organit të kundërvajtjes, si dhe llojet, mënyra e përcaktimit dhe shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse.

Gjate këtij trajnimi janë identifikuar disa dilema lidhur me kompetencën për vendosje me rastin e shqiptimit të sanksioneve nga ana e

inspektoriatit meqë në praktikë, komisioni për vlerësimin e ankesave si organ i shkallës së dytë i cedon lëndët në Gjykatën Themelore, Divizioni për Kundërvajtje, për çka u konstatua se komisioni gabimisht i cedon lëndët në gjykatë meqë në rastet e tilla kompetenca ekskluzive është e komisionit për ankesa, si organ i shkallës së dytë për vendosje lidhur me vendimet e inspektoriatit. Gjithashtu rëndësi e veçantë i'u dha kërkesës për inicimin e procedurës kundërvajtëse, formës dhe mënyrës së përpilimit të kërkesës.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni i kundërvajtjes dhe inspektorët e Drejtorive të Inspektorateve



Trajnim: Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara



Më 11 shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), ka realizuar trajnimin me temë: “Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara”

Ky trajnim vije si rezultat i 2 punëtorive të realizuara gjatë vitit 2021, rezultatet e të cilave u konkretizuan me hartimin e Procedurave standarde të veprimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rreth rasteve të angazhimit të

fëmijëve në punë të rënda dhe punë të detyruara.

Gjatë trajnimit, përveç shpalosjes së materialit të përgatitur dhe analizimit të tij, pjesëmarrësit përmes rasteve hipotetike në grupe punuese kanë prezantuar lidhur me hetimin, gjykimin dhe mbrojtjen e rasteve të punës së rëndë të fëmijëve.

Trajnimi është duke u zhvilluar në mënyrë fizike, sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK-së. Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga gjykatat themelore, Prokurorë nga prokuroritë themelore, mbrojtës të viktimave si dhe zyrtarë nga qendrat për punë sociale.



Program i Specializuar i Trajnimit - Dhuna në familje

Më 15-16 Shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Dhuna në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e drejtë të dispozitave dhe procedurave ligjore në rastet e dhunës në familje dhe zgjidhjen e tyre në mënyrë meritore duke pasur viktimit në qendër dhe duke i mbajtur përgjegjës autorët e krimit në përputhje me standardet ndërkombëtare veçanërisht Konventën e Stambollit.

Trajnimi për dy ditë me radhë u fokusua në: Elementet e përgjithshme dhe ato të veçanta që e përbëjnë figurën e veprën penale të Dhunës në familje, sipas nenit 248 të KPRK-së, Dhunën psikologjike, Dhunën ekonomike, Cilësimin juridik në rastet kur në kuadër të Dhunës në familje është kryer edhe një veprë tjetër penale.


Diskutim i rëndësishëm u zhvillua edhe për Veprat penale dhuna në familje dhe keqtrajtimi

dhe braktisja e fëmijës (elementet e veprës penale dallimi dhe kompetenca), për shkeljen e urdhrat mbrojtës dhe dispozitat ligjore që aplikohen për cilësim juridik.

Poashtu vëmendje e veçantë i'u kushtua edhe Implementimit të udhëzimit të Gjykatës Supreme, (Udhëzuesi me numër Gj.A.Su. 113/2020), Dhunës në familje nga kryesit me çrregullime mendore, Amandamentimin Nr.26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave e quajtur si Konventa e Stambollit, Përdorimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në procedurën penale si pjesë e përlllogaritjes së dënimit me fokus në rastet e dhunës në familje.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët dhe prokurorët nga të gjitha nivelet dhe regjionet e Kosovës.



Trajnim: Shpërblimi i dëmit material dhe jo material dhe praktika gjyqësore

Më 22 Shkurt 2022, është realizuar trajnimi online përmes platformës zoom me temë “Shpërblimi i dëmit material dhe jo material dhe praktika gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e drejt të dispozitave lidhur me përgjegjësinë e dëmit material dhe jo material.

Fokusi i trajnimit ishte në shpërblimin e dëmit si rrjedhojë e dëmeve të shkaktuara e të cilat janë të përfshira sipas mbulesës siguroese, përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit dhe ndarjen e përgjegjësisë, si dhe të praktika gjyqësore e krijuar dhe problemet më të shpeshta në zgjidhjen e këtyre kontesteve.


Gjatë trajnimit është diskutuar se shkaktimi i dëmit është ndër burimet me rëndësi të së drejtës së detyrimeve, ku rregullat e shkaktimit

të dëmit janë të shumta dhe të shumëllojshme sepse përfshijnë raste dhe situata të shumta të marrëdhënjëve që krijohen me vetë faktin e shkaktimit të dëmit.

Një diskutim i rëndësishëm ishte edhe për mënyra e të provuarit në procedurën e shpërblimit të dëmit material dhe jo material si dhe në praktikën për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, gjyqatër dhe prokurorë nga niveli Themelor.



Trajnim: Ndalimi i torturës - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Më 23 Shkurt 2022 është realizuar trajnimi online përmes platformës ZOOM me temë “Ndalimi i torturës - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth Ndalimit të torturës dhe Protokollit të Stambollit..

Trajnimi është fokusuar në trajtimin e koncepteve kryesore të Nenit 3 të KEDNJ. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe Protokollit të Stambollit dhe njohjes ndërkombëtare të Protokollit të Stambollit. Më tej është diskutuar edhe për dokumentimin mjeko-ligjor të torturës dhe etikës mjekësore, për provat fizike dhe psikologjike. Pra, Protokollit të Stambollit u theksua se përshkruan

standardet minimale për respektimin nga shtetet për të siguruar dokumentimin efektiv të torturës në parimet e tij mbi dokumentimin efektiv të torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit tjerë mizor, ç’njëzësor ose degradues, ose parimet e Stambollit.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykatat Themelore, prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale dhe nga Prokuroritë Themelore.



Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar-Sesioni I

Më 23-24 Shkurt 2022, është realizuar trajnimi përmes platformës Zoom me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i organizuar - Sesioni I”.


Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Korniza ligjore ndaj krimit të organizuar dhe tregjet e krimit të organizuar.

Trajnimi në ditën e parë u fokusua në trajtimin e kornizës ligjore ndaj krimit të organizuar dhe tregjeve të korrupsionit, në shkaqet dhe faktorët lehtësues të krimit të organizuar, infiltrimit të krimit të organizuar në biznese dhe në institucione publike si dhe në ndërlidhjen ndërmjet krimit të organizuar, shpëlarjes së parave dhe korrupsionit. Për gjitha këto u parashtruan pyetje dhe njëkohësisht përgjigje nga pjesëmarrësit duke ofruar zgjidhjet ligjore adekuatë në rastet përkatëse.

Në ditën e dytë, trajnimi u fokusua në format e krimit të organizuar dhe format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale. Pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të një rasti studimor i cili kishte të bënte me metodat kryesore të infiltrimit të krimit të organizuar në sistemin e prokurimit të punëve publike në ITALI.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi janë: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelore dhe të apelit si dhe bashkëpunëtor profesional nga Departamenti përkatës si dhe ekspert nga PSRK.



Aktivitetet për profesionet e lira

Dorëzimi i shkresave në Procedurën Përmbartimore



Më 16 shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ, ka organizuar trajnimin me temë: “Dorëzimi i shkresave në Procedurën Përmbartimore”.

Ky trajnim ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit mes AD-së dhe organizatës GIZ, me qëllim të ndihmës dhe ofrimit të trajnimeve edhe për përfituesit tjerë në këtë rast përmbartuesit privat.

Trajnimi u fokusua më shumë në problemet

praktike që hasin përmbartuesit në teren, sidomos me dorëzimin e shkresave nga postat me të cilat ata bashkëpunojnë.

Gjithashtu u diskutuan edhe format e dorëzimit të shkresave, ndërrimi i adresës, fletë dërgesa, dorëzimi subjektiv të regjistruar përmes afishimit etj.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit së bashku me trajnuesin z. Isa Shala diskutuan edhe unifikimin e disa praktikave të punës së tyre, në veçanti kur avokatët harrojnë të parashtrajnë kërkesat e tyre për kompensim të shpenzimeve gjatë prapësimit apo edhe kur bizneset individuale ndërrojnë fushëveprimtarinë nga BI në SHPK.

Përfitues të trajnimit ishin 12 përmbartuesi privat.



Aktivitetet për trajnues

Trajnimi i Trajnuesve për Krimin Kibernetik

Më 08 shkurt 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti iPROCEEDS, ka zhvilluar trajnimin e trajnuesve në fushën e Krimin Kibernetik.


Qëllimi i Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Evropës ishte që përmes këtij trajnimi të punohet me trajnuesit vendor në identifikimin e nevojave trajnuese, e pastaj të krijohet një kuadër i trajnuesve të cilët do të jenë në gjendje t'i realizojnë trajnimet e ardhshme në fushën e Krimin Kibernetik.

Në këtë kuptim, AD dhe KiE kanë menduar një program që fillimisht fokusohet në “mënyrën e realizimit të trajnimit” lidhur me krimin kibernetik dhe provat elektronike. Ky ka për qëllim sigurimin që trajnimi në mënyrë efektive të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të profesionistëve ligjor në raport me krimin kibernetik, si dhe në inspirimin e trajnuesve të ardhshëm që ta tejkalojnë zonën e tyre të



rehatisë, duke kaluar nga mësimdhënia dhe trajnimi i stilit didaktik në teknika më komplekse, sfiduese por sigurisht më efektive të trajnimit. Qëllimi ishte që trajnimet e zbatuara në nivel vendor të jenë në linjë me parimet e arsimit për të rritur, si dhe mjaftueshëm të qasshme për të mundësuar adresimin jo vetëm të njohurisë por edhe të shkathtësive dhe kompetencave praktike të pjesëmarrësve, duke përdorur një shumëllojshmëri të metodave.

Trajnimi i trajnuesve i zgjati për (4) ditë me radhë me çrast u shtjelluan, edhe metodologjitë e trajnimit, mësimi online, mënyrat e përgatitjes për trajnim, si dhe shumë detyra e raste praktike.


Përfitues të trajnimit ishin trajnuesit nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, zyrtarëve policor dhe nga njësia e IT dhe forenzikës.






Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara - Shkurt 2022



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660